




*Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



**Udhëzues Nr. 01/2023  
22.03.2023**

Në mbështetje të nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, paragrafi 1.10, 48, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datë 22.03.2023 nxjerrë këtë:

## **Udhëzues për mbajtjen e seancave dëgjimore të Autoritetit të Konkurrencës**

### **Neni 1** Qëllimi

Ky Udhëzues shërben për përcaktimin e procedurave që ndiqen nga Autoriteti i Konkurrencës dhe ndërmarrjet gjatë seancës dëgjimore, për organizimin e dëgjimeve publike, ku palët do të kenë mundësi të paraqesin informacionet, ose provat e reja bazuar në faktet që i kanë pranuar lidhur me shkeljet e pretenduara gjatë zhvillimit të procedurës hetimore.

### **Neni 2** Palët në procedurë dhe seanca dëgjimore

1. Palët në procedurë janë ndërmarrjet ndaj të cilave Autoriteti zhvillon procedurën hetimore dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim.
2. Propozuesi i fillimit të procedurës nuk është palë në procedurë, përvèç nëse procedura prek të drejtat, ose interesat e propozuesit.
3. Propozuesi i fillimit të procedurës, apo personi, të cilit i njihet kjo e drejtë nga Autoriteti Konkurrencës, me kërkësen e këtij të fundit ftohet në seancë dëgjimore, në pajtim me nenin

35, paragrafi 4, nën paragrafët 4.1 dhe 4.2, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vazhdim të tekstit LMK).

### **Neni 3**

#### **Procedura para seancës dëgjimore**

1. Seancës dëgjimore i paraprin, kryesisht konkluzioni për fillimin e procedurës në pajtim me nenin 37 të Ligjit, njoftimi, të drejtat dhe detyrimet e palës në pajtim me nenin 38 të LMK-së, si dhe mbledhja e të dhënave në pajtim me nenin 39 të LMK-së.
2. Në kuadër të njoftimit paraprak të konstatimit të fakteve, Autoriteti njofton me shkrim palët në procedurë për konstatimin paraprak të fakteve.
3. Në rast të konstatimit se pala në procedurë ka çrregulluar konkurrencën e tregut, ose ka shkelur dispozitat e këtij ligji, në pajtim me nenin 50 të LMK-së, kur konstatohen kushtet për shqiptimin e gjobës, palës i bashkëngjitet ftesa për seancë dëgjimore.
4. Në kuptim të paragrafit 3 të këtij neni, palës i jepet mundësia për të siguruar mbrojtje dhe i paraqiten provat mbi të cilat konstatohet shkelja, shqiptohet gjoba dhe caktohet lartësia e gjobës.

### **Neni 4**

#### **Mbajtja e seancës dëgjimore**

1. Autoriteti i Konkurrencës mban seancë dëgjimore gjatë procedurës.
2. Seancat dëgjimore janë të hapura për publikun.
3. Seancat dëgjimore mund të mbahen të mbyllura me qëllim të ruajtjes së fshehtësisë tregtare.

### **Neni 5**

#### **Mbajtja e seancës dëgjimore**

1. Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, në konsultim me Komisionin dhe Sekretariatin, vendosë mbi mbajtjen e seancës dëgjimore, kur konsideron që është e nevojshme të qartësohen çështje të provave të reja lidhur me rastin që trajtohet.
2. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës zgjedhë raportuesin, i cili kujdeset kryesisht për çështje procedurale, por edhe menaxhimin e fakteve dhe provave.

## **Neni 6**

Thirrja dhe paraqitja e palëve dhe dëshmitarëve

1. Autoriteti i Konkurrencës thërret palët dhe dëshmitarët në procedurë, 8 ditë para planifikimit të mbajtjes së seancës dëgjimore, ku përcaktohet data, koha, dhe vendi i mbajtjes së seancës dëgjimore,
2. Nëse asnjë nga personat e ftuar, ose të autorizuarit e tyre nuk paraqiten në seancë dëgjimore, Autoriteti mund ta shtyjë seancën për një kohë tjeter.
3. Thirrja e të gjitha palëve përmban njoftimin si vijon:
  - 3.1. Institucionin që e lëshon thirrjen;
  - 3.2. Emrin, mbiemrin dhe adresën e të ftuarit;
  - 3.3. Datën, orën dhe vendin;
  - 3.4. Qëllimin e mbajtjes së seancës dëgjimore.
4. Nëse në seancë dëgjimore nuk paraqiten personat e ftuar, ose të autorizuarit e tyre as herën e dytë, Autoriteti mban seancën me palët e pranishme, ose vendosë vetë sipas të dhënave dhe dokumenteve që zotëron.
5. Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, (Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 441).
6. Në procesverbal konstatohet mosparaqitja e personave të ftuar, ose të autorizuarve të tyre.
7. Me kërkesën e propozuesit, Autoriteti fton propozuesin si dëshmitar në seancën dëgjimore.

## **Neni 7**

Gjuha dhe shkrimi gjatë mbajtjes së seancës dëgjimore

1. Seancat dëgjimore mbahen në njëren nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Personi që merr pjesë në seancë dëgjimore, i cili nuk e flet ose nuk e kuption gjuhën në të cilën zhvillohet seanca dëgjimore-procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e tij/saj dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën dhe i sigurohet përkthimi.

## **Neni 8**

Zhvillimi i procedurës së seancës dëgjimore

1. Kryetari i Autoritetit, apo i autorizuari i tij, e drejton seancën dëgjimore, me lejen e kryetarit duke ua dhënë fjalën palëve në procedurë, të tjerëve dhe secilit person prezent në seancë që e kërkon të drejtën e fjalës.
2. Drejtuesi i seancës, me rastin e prishjes së qetësisë dhe pengimit të mbarëvajtjes së seancës dëgjimore, pas tërheqjes së vërejtjes, cilindo nga pjesëmarrësit mund ta largojë nga ambientet ku mbahet seanca dëgjimore.
3. Drejtuesi i seancës ua jep fjalën përfaqësuesve të ndërmarrjes për prezantimin e fakteve të paraqitura dhe atyre të reja, ku më pas ftohen palët të shprehin komentet, apo vërejtjet dhe pyetjet lidhur për rastin. Fjala nuk u ndërpritet folësve në seancë dëgjimore, përderisa janë duke diskutuar për qëllimin e seancës dëgjimore.
4. Personi drejties i seancës, pas dëgjimit të palëve në procedurë, deklaron mbylljen e seancës, ndërsa nëse kërkohet më tepër kohë për shqyrtimin e fakteve dhe rr Ethanave, seanca vazhdon ditën e nesërme, apo në një ditë tjeter.

## **Neni 9**

Drejtimi i seancës dëgjimore

1. Drejtuesi i seancës, pas prezantimit të palëve, ua sqaron palëve rregullat e procedurës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke treguar për çështjen që do të trajtohet në vijim.
2. Të gjitha palëve të interesuara gjatë seancës dëgjimore do t'u jepet e drejta të parashtronë opinionin dhe arsyetimet e tyre lidhur me çështjet që diskutohen.
3. Gjatë një faze të zhvillimit të seancës dëgjimore, me qëllim të ruajtjes së fshehtësisë tregtare, mund të përjashtohet publiku, me kërkesën e palëve dhe vlerësimin e drejtuesit të seancës dëgjimore.
4. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, në përputhje me LMK, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës nuk u siguron qasje në dokumente që përbajnë sekrete tregtare dhe informacione, apo dokumente tjera konfidenciale.

## **Neni 10**

Sigurimi i mbarëvajtjes së seancës dëgjimore

1. Gjatë seancës dëgjimore sigurohet incizimi i të gjitha diskutimeve të palëve, bëhet transkripti, si dhe mbahet procesverbal.
2. Gjatë mbajtjes së seancës dëgjimore salsa duhet të jetë e pajisur me të gjitha mjetet e teknologjisë që mundëson incizim kualitativ përpilimin e transkriptit, ndriçim adekuat, tabela prezantuese, video projektor, si dhe pajisje përkrahëse të teknologjisë për të bërë të mundshme organizimin e dëgjimit në mënyrë virtuale të ekspertit, apo ndonjë pale tjetër.
3. Në anën e djathtë të Drejtuesit vendosen anëtarët e Komisionit të Autoritetit, Drejtori i Përgjithshëm i sekretariatit, Drejtori i Departamentit të Tregut, në cilësinë e parashtruesit të argumenteve dhe fakteve të dyshimta për çrregullimin e konkurrencës gjatë procesit të hetuesisë, si dhe procesmbajtësi.
4. Në anën e majtë ulen përfaqësuesit e kompanive të cilët janë duke u hetuar, si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë.
5. Në anën e majtë ulen edhe dëshmitarët në çështjen e cila trajtohet në seancë dëgjimore.

## **Neni 11**

Mënyra dhe rendi i diskutimit në seancë dëgjimore

1. Drejtuesi i seancës dëgjimore e fillon me fjalën hyrëse, ku është i shkurtër, i qartë dhe i kuptueshëm. Gjatë këtij fjalimi, Drejtuesi të gjithë pjesëmarrësve ua shpjegon thelbin e çështjes, si dhe paraqet të gjeturat e hetuesve të paraqitur në raportin e tyre, së bashku me arsyetimin.
2. Drejtuesi i seancës sigurohet që ta pyesë përfaqësuesin e ndërmarrjes nën hetim se a është në dijeni se për çka fajësohet ndërmarrja e tij.
3. Nëse ndërmarrja e mohon përgjegjësinë apo ka përgjigje negative, atëherë drejtuesi ia sqaron shkurtimisht përmbajtjen e raportit të hetuesit dhe përgjegjësinë e ndërmarrjes.

4. Drejtuesi, pas kësaj, ia shpjegon të drejtat e tij, pra të drejtën për të paraqitur prova përmbrojtjen e tij, si dhe të drejtën për të parashtruar pyetje hetuesve, dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe përfaqësuesve tjera në seancë dëgjimore.
5. Pas shprehjes së qëndrimeve të përfaqësuesve të sekretariatit, të drejtën e kanë palët përt'i kundërshtuar faktet e sekretariatit dhe përt'u përgjigjur në pyetjet e parashtruara.
6. Dëshmitarët, me rastin e paraqitjes së konkluzioneve të hetuesve, së pari e kanë fjalën atatë cilët janë në favor të palës së hetuar, pastaj dëshmitarët në favor të Autoritetit.
7. Komisionerët e Autoritetit e kanë të drejtën, që në fund, të parashtronë pyetjet përfundimtare përpali dhe pas tyre këtë të drejtë e gjelqinë edhe palët përt'u parashtruar pyetje Komisionerëve.
8. Secila palë ka të drejtë të paraqesë prova të reja eventuale me qëllim të marrjes së vendimit të drejtë lidhur me rastin kontestues.
9. Ashtu siç përcaktohet në paragrin 8 të këtij neni, deri në përfundim e seancës dëgjimore, palët mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja apo mbledhjen e provave të reja.

### **Neni 12**

#### Mënyra e paraqitjes së dëshmitarëve

1. Drejtuesi i seancës dëgjimore duhet të marrë në konsideratë mocionet e palëve në cilësinë e dëshmive të dëshmitarëve jo ekspertë (kjo përfshinë paraqitjet e kundërshtimeve të konstatimeve në raportin e zyrtarëve hetues të Autoritetit dhe nëse kërkohet paraqitja e rrethanave të reja të çështjes, lejon thirrjen e dëshmitarëve të tjera).
2. Drejtuesi i seancës mund të angazhojë ekspertë profesionalë të konkurrencës gjatë seancës.
3. Autoriteti i konkurrencës përcakton listën me ekspertë të përzgjedhur profesionalë të konkurrencës, të cilët i angazhon sipas nevojës se rasteve ne pajtim me legjisacionin ne fuqi.
4. Eksperti mund ta paraqesë ekspertizën e tij me shkrim apo gjatë seancës dëgjimore, ku në raste të caktuara dhe me lejen e Drejtuesit, mund të deklarohet edhe përmes video konferencës, apo në mënyrë tjetër virtuale.

- Nëse eksperti ka bërë raport me shkrim lidhur me rastin, Autoriteti do t'ua dorëzojë një kopje të raportit palëve të përfshira në proces.
- Palët, me rastin e angazhimit të ekspertit, obligohen të bashkëpunojnë me ekspertin e çështjes dhe ia ofrojnë të gjitha informacionet me interes të çështjes.

**Neni 13**  
Konfidencialiteti dhe paanshmëria

- Eksperti, me rastin e të dhënave konfidenciale, apo fshehtësisë tregtare, nënshkruan deklaratën e konfidencialitetit.
- Po ashtu, eksperti nënshkruan edhe deklaratën për paanshmëri dhe njëherazi deklarohet për mosekzistimin e çfarëdo rrethane që e bëjnë të papërshtatshëm për ekspertizën e rastit.
- Këtyre obligimeve i nënshtrohen edhe dëshmitarët, duke nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit dhe të paanshmërisë.

**Neni 14**  
Përfundimi i seancës dëgjimore

- Seanca dëgjimore përfundon me nënshkrimin e procesverbalit nga drejtuesi i seancës, palët dhe procesmbajtësi.
- Në procesverbal evidentohen palët pjesëmarrëse në seancë, koha dhe vendi i mbajtjes së seancës, drejtimi i seancës, thirrja e palëve, faktet dhe provat e paraqitura me radhë, prezencia dhe deklarimet e dëshmitarëve, eksperti dhe ekspertiza e tij, si dhe ora e përfundimit të seancës.

22.03.2023

**Kryetare**

Neime Binaku - Isufi

